

VENDIM
Nr. 46/2017

**PËR KRIJIMIN DHE PËRBËRJEN E KOMISIONIT *AD HOC* ME 6 ANËTARË TË
PËRZGJEDHJES SË KANDIDATËVE PËR INSTITUCIONET E RIVLERËSIMIT,
SIPAS LIGJIT NR. 84/2016, “PËR RIVLERËSIMIN KALIMTAR TË GJYQTARËVE
DHE PROKURORËVE NË REPUBLIKËN
E SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës, nenit 55, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, dhe të nenit 9, pikat 1, 2 dhe 3, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me propozimet e kryetarëve të grupeve parlamentare,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Krijimin e Komisionit Parlamentar *Ad Hoc* të përzgjedhjes së kandidatëve për institucionet e rivlerësimit, sipas ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me 6 anëtarë, të ndarë në mënyrë të barabartë midis shumicës dhe pakicës parlamentare.

II. Përbërja e Komisionit Parlamentar *Ad Hoc* për përzgjedhjen e kandidatëve është si më poshtë:

a) Nga grupet parlamentare të shumicës parlamentare caktohen:

1. Vasilika Hysi (PS)
2. Ervin Bushati (PS)
3. Vangjel Tavo (LSI)

b) Nga grupet parlamentare të pakicës parlamentare caktohen:

1. _____
2. _____
3. _____

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Miratuar në datën 18.4.2017

KRYETARI
Ilir META

